



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E GJILANIT
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

AD.GJTH.GJL.nr.8/23

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, përmes kryetarit të gjykatës Venhar Salihu, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, duke vepruar sipas ankesës së parashtruar nga ankuesi A. H. nga fshati Remnik, Komuna e Vitisë, të datës 90.10.2023, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit N. A. - gjyqtar në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Viti, më datë 17.10.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e datës 05.10.2023 e paraqitur nga A. H. nga fshati Remnik, Komuna e Vitisë, për iniciimin e procedurës disiplinore konform Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, të paraqitur ndaj gjyqtarit N. A. - gjyqtar në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Viti.

A r s y e t i m

Kjo gjykatë me dt. 05.10.2023, ka pranuar ankesë nga A. H. nga fshati Remnik, Komuna e Vitisë, ndaj gjyqtarit N. A. - gjyqtar në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Viti, duke theksuar se ka zvarritje të lëndës së tij, pasi e njëjta është paraqitur në vitin 2018, është lëndë e natyrës urgjente për shkak të lëndimeve të rënda trupore që ka pësuar paditësi nga aksidenti, objekt i kontestit sipas çështjes kontestimore C.nr.490/18. Ankesës, paditësi i ka bashkëngjitur urgjencat e dorëzuara në gjykatë më datë 10.02.2023, 19.09.2022, 11.02.2022, 21.10.2021, 16.06.2023, 31.07.2019, 12.02.2021, 29.07.2021, 21.10.2020, 13.01.2022 dhe 04.10.2021.

Gjyqtari N. A. në deklaratën e tij të datës 13.10.2023, lidhur me pretendimet e ankuesit ka theksuar se i njëjti ka qenë gjyqtar i lëmisë penale, ku në Janar të vitit 2023 ka kaluar në lëminë civile, ndërsa me të njëjtat ka filluar të punojë nga muaji Maj i vitit 2023, pra 5 muaj e gjysmë. Lëndët civile që ka pranuar, ka shtuar se datojnë nga viti 2011 e deri në vitin 2023, pra ka lëndë më të vjetra

sesa lënda e ankuesit, ndërsa gjyqtari është duke iu përmbajtur strategjisë shtetërore për kryerjen e lëndëve të vjetra.


Kryetari i gjykatës, pas pranimit të ankesës të paraqitur nga pala ankuese (paditësit sipas lëndës C.nr.490/18), deklaratës së paraqitur nga gjyqtari N [REDACTED] A [REDACTED] dhe analizimit të pretendimeve të ankuesit, ka gjetur se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë më ndonjë shkelje të mundshme disiplinore, duke vlerësuar se ankesa e palës ankuese e dt. 09.10.2023, është e pabazuar dhe pretendimet e të njejtit nuk e justifikojnë iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit në fjalë.

Deri te një përfundim i tillë, kryetari i gjykatës erdhi pas vlerësimit dhe analizimit me shumë kujdes të pretendimeve të palës ankuese të paraqitura në ankesën e tij dhe gjeti se veprimet e gjyqtarit N [REDACTED] A [REDACTED] janë ndërmarrë duke zbatuar strategjinë përkatëse për procedimin e lëndëve – sipas vitit të iniciuar të lëndës dhe natyrës së çështjes. Nga evidenca e lëndëve të dorëzuara gjyqtarit N [REDACTED] A [REDACTED] shihet se është i ngarkuar me lëndë të vitit 2018, si dhe ka edhe lëndë të viteve të mëhershme.

Nga këto, arsyje kryetari i gjykatës vlerëson se nuk mund të konsiderohet se gjyqtari në fjalë ka vepruar në kundërshtim me etikën e gjyqtarit, e as nuk ka bërë ndonjë shkelje disiplinore, ngase gjyqtari i çështjes nuk ka neglizhuar lëndën, por e njëjta është në pritje sipas renditjes së paraparë (në bazë të vitit dhe natyrës së lëndës).

Andaj kryetari i kësaj gjykate, konform nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, ka gjetur se ankesa e ankuesit Arsim Hyseni e datës 09.10.2023, është e pabazuar dhe për të njejtën ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kryetari i Gjykatës,
Venhar Salihu



Këshillë Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Vendimi duhet i dorëzohet:

1. Gjyqtarit N [REDACTED] A [REDACTED],
2. Parashtruesit të ankesës,
3. KGJK-së
4. Dosjës së lëndës.